

# Partneritet për zhvillim

Aty ku shteti nuk ka potencial që vetë të ofrojë një shërbim, ai thërret në ndihmë bizneset private. Kështu ndodh në shumë vende të botës, por te ne ende nuk janë krijuar mekanizmat ligjorë për një partneritet publik- privat.

Delfin Pilana

**A**ty ku shteti nuk ka potencial që vetë të ofrojë një shërbim, ai thërret në ndihmë bizneset private. Partneritetet publike-private në shumë vende ekzistojnë që moti. Kjo vjen si rjedhojë e kërkesave të mëdha për ofrimin e shërbimeve, që qeveritë gendrore apo ato lokale për shkak të kufizimeve financiare nuk kanë mundur t'i realizojnë vetë.

Partneritetet publike-private nën-kuptojnë bashkëpunim të bartësve të politikave publike si qeverive qendrore apo atyre lokale me kompani private në përmbyshjen e detrave publike, ku shteti më shumë merret me menaxhimin e shërbimeve sesa zbatimin e tyre. Përgjithësisht, fushat në fokus të bashkëpunimit të PPP llogariten të jenë ndërtimi apo renovimi i infrastrukturës rrugore, përmirësimi i shërbimeve komunale, infrastrukturës sociale etj.

Në Kosovë nuk janë shumë të përmendura këto bashkëpunime përvëç në seminare ose konferenca, ku IPVQ-ve u sugjerohet se duhet të mendojnë që problemet sidomos në infrastrukturë mund të anashkalohen edhe me arranzhime të përbashkëta investuese me sektorin privat.

"Parimingt PPP-të nënkuptojnë investimet private në projekte infrastrukturore ku shteti nuk ka mjete materiale për të investuar. Projektet mund të jenë p.sh. projekte transporti, përrugullim rrugësh, urash, hekurudhash apo projekte në mjetid, rivënje në funksion të burimeve energetike etj.", sqaron Hans Juergen Zahorka, ish-anëtar i Parlamentit Evropian dhe eksperti i qëshjeve evropiane.

Zahorka u paraqiti shërbvese njohuri themelore mbi këtë partneritet në një trajnim të organizuar nga Sofreco dhe të mbështetur nga AER e qeveria e Kosovës.

"Si edhe çdo vendi tjetër evropian, edhe Kosovës është mjetë përfundim i projekteve të tilës, kështu që qytetarët dhe ekonomia kosovare qartazi ka përfitim nga PPP-të".

Zahorka propozoi idenë e krijimit të një grupi punues për vënien në funksion të PPP-ve në Kosovë. "Gru-



Ejup Qerimi, Oda Ekonomike e Kosoves

pet punuese duhet të jenë profesionale dhe të punojnë sistematikisht. Shumica e vendeve evropiane i kanë të themeluara tashmë grupet punues ndërmindistre. Psh. në Gjermani secili region ("Land") e ka grupin punues për PPP-të, të cilat e kanë webfaqen dhe në këtë mënyrë qeveritë lokale dhet qytetarët mund të jenë pjesëmarrës në diskutimet, propozimet që kanë të bëjnë me PPP-të. Unë kam propozuar krijimin e një grupi punues këtu në Kosovë dhe reagimet e para kanë qenë shumë pozitive, posaçërisht nga sekretari permanent i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, z. Sefedin Sefaj".

I pyetur përmes qytetarëve të BE-së

Zahorka përmend disa prej tyre si p.sh. rreziqet politike apo sa i përket mbrojtjes së mijedisit, megjithatë ai shton se këto rreziqe duhet vlerësuar seriozisht përmes listave të mjafqueshme kontrolluese. Kompatibiliteti i ligjeve vendore me atë të BE është një parakusht themelor drejt rrugës për integrim në BE, ndërsa konkretisht baza ligjore e PPP-ve në relacion me ligjin e BE ende nuk është e rregulluar. "PPP-të momentalisht nuk janë pjesë e ndonjë dispozite apo rregullore brenda ligjit të BE. Ligji i BE është shumë më pak byrokratik sesa ligjet e anëtarëve të saj. Mirëpo, ekziston një mendim i përgjithshëm se duhet të ekzistonjë rregulla brenda ligjit të BE sa i për-

ket prokurimit publik, të cilat do të favorizonin njësoj pjesëmarrjen edhe të investituesve privatë jashtë BE në projektet e PPP", sqaron Zahorka. Ai shton se vendet në tranzicion përgjithësisht kanë pasur përvaja të mira me PPP-të, me gjithë faktin se ende ekziston pikëpamja tradicionaliste e shtetit si ofrues kryesor i shërbimeve publike.

Nga ana tjeteri, organizmat insti-

tucionale vendorë si dhe ata të sekritor joqeveritar shprehen pozitivish për mundësinë e vënieve në jetë të PPP-ve, edhe pse disa prej tyre janë skeptikë nëse PPP-të duhet të janë prioritet për momentin.

Sefedin Sefaj, sekretar i përhershëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, mendon se është ende herët që PPP-të të funksionalizohen tek ne meqë duhet kohë për të iden-

**ecoterm DERIVAT**

■ Janë instrumente financiare që ekzistojnë në funksion të aktiviteteve te tjera financiare. Janë instrumenta me një komponentë forte spekulativë që shpesh përdoren për të mbuluar risqet financiare dhe monetare.

Quelle/SOURCE: "Express", Kosovo, 17.8.2005

## Kina shet bankën e parë

Për herë të parë shteti i mbi 2 miliardë banorëve, Kina planifikon të shesë shumicën e aksioneve të saj në bankën e Zhvillimit të Guangdongut, duke hequr dorë për herë të parë nga drejtimi i një institucionin financiar shtetëror. Carlyle Group, JPMorgan Partners LLC dhe DBS Group Holdings Ltd. shihen si blerësit më

të mundshëm për këtë bankë. Blerësi i kësaj banke do të ketë mbi vete 25 përqind të aksioneve në këtë bankë. Banka e zhvillimeve renditet e dyta për nga madhësia në provincën jugore të Guangdongut, në kufi me Hong Kongun. Qeveria kinezë kontrollon më shumë se 90 përqind të një totali prej 4,3 trillionë

dollarësh në asete bankare dhe po inkurajojnë bankat huadhenësë të pastrojnë huat e këqija, të përmirësojnë menaxhimin dhe të hapin dyert për investitorët e huaj. Bankat e Kinës kanë më shumë se 205 miliardë dollarë huia të këqija pas pesë dekadash, që kur sistemi bankar udhëhiqet nga shteti.



tifikuar njerëz dhe institucione që në të ardhmen do të merren me këtë veprimtar.

"Mendoj se proceset që kanë të bëjnë me PPP-të varen shumë nga suksesi i PVQ-ve në finalizimin e listës së Programeve të Investimeve Publike (PIP), e cila është e planifikuar përfund të vitit 2005. Aty do të identifikohen ato projekte të cilat janë për PIP dhe mund të inkorporohen në periudhën afatmesme buxhetore, duke përfshirë burimet nga BKK-ja (Buxheti i Konsoliduar i Kosovës), si dhe ato burime që vijnë nga donatorët", thotë Sefaj.

Ai shton se vetëm pas realizimeve të mëlartëshkruara pason faza e identifikimit të projekteve që kanë të bëjnë me PPP-të, ndërsa krejt kjo varet edhe nga procesi i privatizimit dhe siguria për investimet nga jashtë e atë në radhë të parë të diasporës shqiptare. Sefaj përmend edhe reportin e progresit për implementimin e planit të veprimit për partneritetin evropian për Kosovën (Qershori, 2005), prej të cilit rjedhin dy prioritete që kanë të bëjnë

### SHEMBUJ TË PARTNERITIT PUBLIK PRIVAT

Ambasada britaneze në Berlin është ndërtuar përmes PPP-së. Aeroporti i Tbilisit në Gjeorgji do të rinovohet dhe zgjerohet nga një konsorcium i përbashkët nga kompanitë BE, Turqisë dhe Gjeorgjisë, pastaj për 11 vjet të gjitha të ardhurat nga aeroporti do të shkojnë në llogari të tyre, me përashtim të 10% të cilat i dedikohen shtetit. Pas 11 vjetëve shteti do të vendosë se kush do të udhëheqë aeroportin në 10 vjetët e ardhshme. Në rajonin e Frankfurtit në Gjermani, 60 shkolla fillore janë renovuar dhe pastaj janë drejtuar (teknikisht) nga kompanitë e ndërtimit, ndërsa qeveritë lokale kanë qenë të obliguar që për një periudhë të caktuar 15-20 vjet t'u paguanjë një shumë të vogël të të hollave kompanive të ndërtimit. Pastaj në Itali, Francë, Spanjë, ndërtimi i autostradave është finansuar nga kompanitë private, të cilat marrin shumë të caktuar të mjetetë nga shfrytëzuesit e autostradave. E rëndësishme: PPP-të në shumicën e rasteve janë një angazhimi afatgjatë, nga 5-50 vjet.

me PPP-në; ai 34 dhe 35 që përbajnë: Miratimin e një plani për veprim mbi kornizën politike për PPP-të – Partneriteti publik private për ndërtimin e infrastrukturës përcështjet e transportit, miratimin e një plani veprimi për kornizën politike për PPP-në dhe investimet

mikse në sektorin energetik dhe zhvillimin e modeleve të investimeve për PPP për produhues të ri të energjisë elektrike dhe mundësitet përvitimi në miniera të linjitet.

Si akterë bartës të funksionalizimit të PPP-në Kosovë, Sefaj përmend Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit (MTPT),

Ministrinë e Energjisë dhe Ministrinë (MEM) si dhe Ministrinë për Ekonomi dhe Financa (MEF), ndërsa si mbështetës kryesor llogarit Bankën Botërore dhe Agjencionin Evropian për Rindërtim.

Ejup Qerimi nga Oda Ekonomike e Kosovës shprehet optimist përshtet që mund të ofrojnë PPP-të.

"Funkksionalizimi i tyre mund të bëhet kur qeveria e Kosovës i i identifikojë së pari projektet, t'i dizajnojë ato dhe pastaj të shpalë tender publik për të tjerëqur partnerët e mundshëm privatë", theksion z. Qerimi, duke përmendur këtu llojet e mundshme të kontratave që mund të bëhen me partnerët privatë si p.sh. kontrata BOT.

Qerimi potencion se përmomitet do të ishte e udhës që qeveria të fillojë me disa pilot projekte të vogla për ta mësuar mënyrën e funksionimit, ndërsa sa i përket rolit që OKE mund të luajë në këtë process, ai thotë se OKE mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm së pari duke ndihmuar dialogun në mes të partnerëve të mundshëm publikë dhe privatë si dhe në nxitjen e të dy

palëve që të hyjnë në aranzhime të përbashkëta.

Është fakt se PPP-të nuk janë shumë aktuale në listat prioritare të investimeve qeveritare, megjithatë është i nevojshëm krijimi i një mekanizmi punues i cilë fillimi i mund të informojë akterët relevantë mbi përfitimet, rreziqet dhe mundësitet e realizimit konkret për PPP-ve në Kosovë, dhe gjithashu, marrë parasysh tkurjen e buxhetit të Kosovës, PPP-të mund të paragjen si lehtësues në balancimin e kërkuesave përvitimi publike në fusha të ndryshme.

### SHIFRA

# 0.5

Përqindja e shtimit të inflacionit në SHBA, si pasojë e ngritisë së çmimit të naftës në muajin korrik.